

URDHËR
Nr. 644, datë 12.12.2025

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE DHE ÇAKTIMIN E DETYRAVE TË
ZËVENDËSMINISTRIT TË MJEDISIT ZNJ. ELDA XHUMARI

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 22, 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; dhe të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Mjedisit, zëvendësministres së Mjedisit, znj. Elda Xhumari, për ushtrimin e kompetencave në fushën e mbrojtjes së mjedisit, mbrojtjes nga ndryshimet klimatike, biodiversitetit, zonave të mbrojtura, menaxhimit të pyjeve, ekonomisë qarkulluese, menaxhimit të mbetjeve, monitorimit mjedisor dhe vlerësimit të ndikimit në mjedis.

2. Në ushtrim të kompetencave të deleguara sipas pikës 1 të këtij urdhri, zëvendësministria ngarkohet të kryejë detyrat e mëposhtme:

a) Ndjek dhe koordinon proceset që lidhen me zbatimin e programit të qeverisë në fushën e mbrojtjes së mjedisit, menaxhimit të mbetjeve, biodiversitetit, pyjeve, ndryshimeve klimatike dhe ekonomisë qarkulluese, përfshirë strategjitë kombëtare dhe planet e veprimtimit përkatëse;

b) Kontribuon në hartimin, plotësimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor në fushën e mjedisit, duke përfshirë mbetjet, vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe vlerësimin strategjik mjedisor (EIA/SEA), zonat e mbrojtura, pyjet, monitorimin mjedisor, ndotjen industriale, cilësinë e ajrit, ekonominë qarkulluese, ndryshimet klimatike – në përputhje me *acquis* të BE-së dhe angazhimet e kapitullit 27;

c) Ndjek procedurat për hartimin e projektakteve ligjore e nënligjore, në përputhje me planin vjetor të projektakteve, të miratuar, si dhe çdo akti tjetër ligjor e nënligjor në fushën e mjedisit;

ç) Monitoron dhe koordinon zbatimin e strategjive dhe programeve kombëtare mjedisore, dhe nënshkruan aktet përkatëse, përfshirë:

i. Strategjinë Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve;

ii. Strategjinë e Biodiversitetit;

iii. Dokumentin e politikave për pyjet në Shqipëri, 2019–2030;

iv. dokumentin strategjik dhe të planeve kombëtare për zbutjen e gazeve me efekt serrë dhe për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike;

d) Siguron të dhëna, analiza dhe raporte periodike mbi politikat kombëtare të mjedisit dhe progresin e tyre drejt përafrimit me *acquis* të BE-së;

dh) Ndjek performancën e strukturave vartëse, përfshirë Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM), Agjencinë Kombëtare të Pyjeve (AKP), Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM) dhe Agjencinë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve (AKEM);

e) Drejton grupe pune për analizimin dhe përmirësimin e programeve dhe projekteve në bashkëpunim me ekspertë vendës dhe ndërkombëtarë;

ë) Trajton dhe monitoron kthimin e përgjigjeve për kërkesat dhe ankesat e institucioneve publike dhe organizmave të tjerë në fushën e mjedisit;

f) Ndjek dhe nënshkruan aktet e nxjerra në bazë të legjislacionit në fuqi, përfshirë edhe autorizimet që lëshon ministri, në rast mungese të tij, sipas aktit përkatës të delegimit;

g) Përfaqëson Ministrinë në këshilla, komisione, grupe pune dhe procese ndërinstitutionale brenda dhe jashtë vendit, sipas delegimit dhe fushës së përgjegjësisë;

gj) Bashkëpunon dhe koordinon me zëvendësministrat e tjerë për çështje ndërsektoriale, që lidhen me mjedisin dhe ndryshimet klimatike;

h) Informon periodikisht dhe sipas nevojës Kabinetin e Ministrit për ecurinë e detyrave dhe zbatimin e tyre.

3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë të lehtësojë dhe mbështesë zëvendësministrin për përmbushjen e detyrave të ngarkuara.

4. Delegimi i kompetencave sipas këtij urdhri përfundon me shfuqizimin e aktit të delegimit, si edhe me pushimin e ekzistencës së organit delegues ose të deleguar.

5. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri zëvendësministri i Mjedisit, znj. Elda Xhumari, dhe Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I MJEDISIT
Sofjan Jaupaj